

PHILIPS

Kufje

Seria 4000

TAT4507



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në
www.philips.com/support

Përmbajtja

1	Udhëzime të rëndësishme sigurie	2
	Siguria e dëgjimit	2
	Informacione të përgjithshme	2
2	Kufjet tuaja True wireless	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Pajisjet e tjera	3
	Përmbledhje e kufjeve tuaja True Wireless	4
3	Fillimi	5
	Karikimi i baterisë	5
	Si vendosen	6
	Çiftimi i kufjeve me pajisjen me Bluetooth për herë të parë	6
	Çiftimi i kufjeve me një pajisje tjetër me Bluetooth	7
4	Përdorimi i kufjeve	8
	Lidhja e kufjeve me pajisjen tuaj me Bluetooth	8
	Ndezja/fikja	8
	Kontrollimi i telefonatave dhe muzikës	8
	Asistenti me zë	9
	Drita LED treguese e kufjeve/kutisë së karikimit	9
5	Rivendosja e kufjeve	10
6	Të dhëna teknike	10
7	Njoftim	11
	Deklarata e konformitetit	11
	Hedhja e produktit dhe baterisë të vjetër	11
	Heqja e baterisë së brendshme	11
	Pajtueshmëria me EMF	12
	Informacione mjedisore	12
	Njoftim për pajtueshmërinë	12
8	Marka tregtare	14
9	Pyetje të bëra shpesh	15

1 Udhëzime të rëndësishme sigurie

Siguria e dëgjimit



Rrezik

- Për të shmangur dëmtimin në dëgjim, kufizoni kohën që e përdorni kufjet me volum të lartë dhe vendoseni volumin në një nivel të sigurt. Sa më i lartë të jetë volumi, aq më e shkurtër është koha e dëgjimit.

Sigurohuni të ndiqni udhëzimet e mëposhtme kur i përdorni kufjet.

- Dëgjoni në volume të arsyeshme për periudhave kohore të arsyeshme.
- Kujdes të mos rregulloni vazhdimisht volumin lart pasi të dëgjuarit tuaj përshtatet.
- Mos e ngrini volumin kaq shumë sa që të mos dëgjoni çfarë ka rreth jush.
- Ju duhet të përdorni kujdes ose të ndërpritni përkohësisht përdorimin në situata të mundshme të rrezikshme.
- Tingujt tepër të fuqishëm nga kufjet mund të shkaktojnë humbje të dëgjimit.
- Përdorimi i kufjeve me të dy veshët e mbuluar gjatë drejtimit të automjetit nuk rekomandohet dhe mund të jetë i jashtëligjshëm në disa zona.
- Për sigurinë tuaj, shmangni shpërqendrime nga muzika ose telefonatat ndërsa jeni në trafik ose në mjedise të mundshme të rrezikshme.

Informacione të përgjithshme

Për të shmangur dëmtimin ose keqfunksionimin:



Kujdes

- Mos i ekspozoni kufjet në nxehtësi ekstreme.
- Mos i rrezoni kufjet.
- Kufjet nuk duhet të ekspozohen ndaj spërkatjeve ose lëngjeve. (Shikoni vlerësimin IP të produktit specifik)
- Mos lejoni që kufjet të zhyten në ujë.
- Mos i karikoni kufjet kur konektori ose priza është e lagur.
- Mos përdorni agjentë pastrimi që përmbajnë alkool, amoniak, , benzinë, ose gërryes.
- Nëse nevojitet pastrim përdorni një leckë të butë, nëse është e nevojshme me një sasi të ulët uji ose sapun të butë të shkrirë, për të pastruar produktin.
- Bateria e brendshme nuk duhet të ekspozohet ndaj nxehtësive të tepërta si për shembull drita diellit, zjarri ose të ngjashme.
- Rrezik shpërthimi nëse bateria është zëvendësuar në mënyrë të gabuar. Ndërrojeni vetëm me bateri të njëjtë ose me të njëjtin tip.
- Për të arritur vlerësimin IP specifik, kapaku i hapësirës së karikimit duhet të jetë i mbyllur.
- Hedhja e baterisë në zjarr ose në furrë, ose shtypja apo prerja mekanikisht e baterisë mund të shkaktojë shpërthim.
- Lënia e baterisë në ambient me temperaturë tepër të lartë mund të shkaktojë shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të djegshëm.
- Në rast se bateria lihet në presion atmosferik tepër të ulët, kjo mund të shkaktojë shpërthim ose rrjedhje të lëngut ose gazit të djegshëm.

Temperaturat dhe lagështia gjatë përdorimit dhe ruajtjes

- Mbajeni në një vend ku temperatura është në temperaturë ndërmjet -20 °C dhe 50 °C me lagështi relative deri në 90%.
- Përdoreni në një end ku temperatura është ndërmjet 0 °C dhe 45 °C me lagështi relative deri në 90%.
- Jetëgjatësia e baterisë mund të jetë më e shkurtër në kushte temperature të lartë ose të ulët.
- Nëse bateria ndërrohet me një tip baterie të gabuar, kjo rrezikon të dëmtojë kufjet dhe baterinë (për shembull, në rastin e disa llojeve të baterive të litiumit).

2 Kufjet tuaja True wireless



Manuali i përdorimit

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në www.philips.com/welcome. Me këto kufje Philips True, ju mund:

- të bëni telefonata të rehatshme nëpërmjet valëve pa përdorur duart
- të dëgjoni dhe të kontrolloni muzikën me anë të valëve
- kaloni nga telefonata në muzikë ose anasjelltas




Garancia botërore



Fletëpalosja e sigurisë

Çfarë ka në kuti



Kufje Philips True Philips TAT4507



Kupa rezervë prej gome për veshët x 3 çifte




Kablllo karikimi USB-C (vetëm për karikim)

Pajisjet e tjera

Një celular ose pajisje (p.sh. laptop, tabletë, adaptorë Bluetooth, aparate MP3 etj.), e cila ka Bluetooth dhe është e pajtueshme me kufjet.

Përmbledhje për kufjet tuaja True Wireless



- ① Treguesi LED (kufjet)
- ② Prekje multi-funksionale
- ③ Vendi i karikimit USB-C
- ④ Treguesi LED (kutia e karikimit)
- ⑤ Drita treguese LED (çiftimi BT dhe rivendosja)
- ⑥ Butoni i çiftimit me Bluetooth

3 Fillimi


Karikimi i baterisë

Shënim

- Para se t'i përdorni kufjet, vendosini në kutinë e karikimit dhe karikoni baterinë për 2 orë për të pasur kapacitet dhe jetëgjatësi optimale të baterisë.
- Përdorni vetëm kablo karikimi origjinale USB-C për të shmangur dëmtimet.
- Mbaroni telefonatën para se t'i karikoni. Kur kufjet lidhen për t'u karikuar, ato fiken.

Kufjet

Nxirrini kufjet dhe hiqni etiketat e izolimit.
Vendosini kufjet përsëri në kutinë e karikimit dhe mbylleni kapakun; më pas kufjet fillojnë të karikohen.




Këshillë

- Normalisht, një karikim i plotë zgjat 2 orë (për kufjet ose kasën e karikimit).

Kasa e karikimit

Lidhjeni njërën anë të kabllot USB-C në kasën e karikimit dhe anën tjetër te burimi i energjisë.



Këshillë


- Kasa e karikimit shërben si bateri rezervë portative për të karikuar kufjet. Kur kasa e karikimit është e karikuar plotësisht, ajo i karikon plotësisht kufjet 3 herë.

Si vendosen

Zgjidhni maja të përshtatshme për qëndrim optimal


Qëndrimi i puthitur dhe i sigurt siguron cilësinë më të mirë të zërit dhe të izolimit të zhurmës.

- 1 Proveni cilat maja ju japin zërin më të mirë dhe rehatinë më të madhe.
- 2 Janë siguruar 3 masa të majave të silikonit për veshët: të mëdha, mesatare, të vogla.




Vendosni kufjet

- 1 Kontrolloni orientimin majtas ose djathtas të kufjeve.
- 2 Vendosini kufjet në veshë dhe rrotullojini paksa derisa t'i keni pozicionuar mirë.



Çiftimi i kufjeve me pajisjen me Bluetooth për herë të parë

- 1 Sigurohuni që kufjet janë të karikuara plotësisht dhe të fikura.
- 2 Hapni kapakun e kutisë së karikimit. Mbani shtypur butonin e çiftimit për rreth 3 sekonda.



- ↳ Dritat LED në të dyja kufjet pulsojnë me radhë në ngjyrë të bardhë dhe blu
- ↳ Tani kufjet janë në modalitetin e çiftimit dhe janë gati për t'u çiftuar me një pajisje me Bluetooth (p.sh. një celular)
- 3 Aktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth.
 - 4 Çiftoni kufjet me pajisjen tuaj me Bluetooth. Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes me Bluetooth.

Shënim

- Pasi t'i keni ndezur, nëse kufjet nuk gjejnë dot asnjë prej pajisjeve me Bluetooth të lidhura më parë, ato kalojnë automatikisht në modalitetin e çiftimit.

Shembulli i mëposhtëm tregon si t'i çiftoni kufjet me pajisjen tuaj me Bluetooth.

- 1 Aktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth, zgjidhni **Philips TAT4507**.
- 2 Formoni "fjalëkalimin e kufjeve "0000" (4 zero) nëse kërkohet. Për ato pajisje që kanë Bluetooth 3.0 ose më të lartë, nuk ka nevojë të vendoset fjalëkalim.



Philips TAT4507

Çiftimi i kufjeve me një pajisje tjetër me Bluetooth

Nëse doni të çiftoni një pajisje tjetër me Bluetooth me kufjet, thjesht vendosini në modalitetin e çiftimit, (shtypni butonin në kuti për 3 sekonda me të dyja kufjet brenda dhe me kapakun të hapur), më pas gjeni pajisjen e dytë sipas çiftimit normal.

Shënim

- Kufjet ruajnë 4 pajisje në memorie. Nëse mundoheni të çiftoni më shumë se 4 pajisje, pajisja e çiftuar e para zëvendësohet me atë më të fundit.

Vetëm një kufje (modaliteti Mono)

Nxirreni kufjen e djathtë ose të majtë nga kutia e karikimit për përdorim Mono. Kufja do të ndizet automatikisht.

Shënim

- Asistenti me zë është i çaktivizuar në modalitetin Mono.
- Hiqeni kufjen e dytë nga kutia e karikimit dhe ato do të çiftohen automatikisht me njëra-tjetrën.

4 Përdorimi i kufjeve

Lidhini kufjet me pajisjen tuaj me Bluetooth

- 1 Aktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth.
- 2 Hapni kapakun e kutisë së karikimit.
 - ↳ Drita LED blu pulson
 - ↳ Kufjet do të kërkojnë pajisjen me Bluetooth me të cilën janë lidhur për herë të fundit dhe do të lidhen përsëri me të automatikisht. Nëse pajisje me të cilën janë lidhur për herë të fundit nuk është e disponueshme, kufjet do të hyjnë në modalitetin e çiftimit

Këshillë

- Kufjet mund të lidhen me më shumë se 1 pajisje njëkohësisht. Nëse keni dy pajisje të çiftuara me Bluetooth, aktivizoni vetëm Bluetooth në pajisjen me të cilën doni të lidheni.
- Nëse aktivizoni funksionin e pajisjes suaj me Bluetooth pasi të keni ndezur kufjet, duhet të shkoni në menynë e Bluetooth të pajisjes dhe t'i lidhni manualisht kufjet me pajisjen.

Shënim


- Nëse kufjet nuk lidhen me asnjë pajisje Bluetooth brenda 3 minutash, ato do të fiken automatikisht për të kursyer baterinë.
- Në disa pajisje me Bluetooth, lidhja mund të mos jetë automatike. Në këtë rast, duhet të shkoni në menynë Bluetooth të pajisjes dhe t'i lidhni manualisht kufjet me pajisjen me Bluetooth.

Kontrolli ANC (anulimi aktiv i zhurmës)

Aktivizimi i ANC

Modalitetet e ndryshme ANC mund të ndryshohen duke shtypur dy herë në kufjen e djathtë.

- Funkzioni ANC aktivizohet automatikisht kur vendosen në vesh
- Prekni dy herë MFT, ato do të kalojnë në modalitetin e vetëdijes
- Prekni përsëri dy herë MFT, funksioni ANC do të fiket



Këshillë

- Heqja e kufjeve do të aktivizojë automatikisht modalitetin e gjumit. Kur i vendosni përsëri kufjet, ato do të kthehen në modalitetin aktiv.

Detyra	MFT	Punimi
ANC aktive	Kufja e djathtë	Dy shtypje
Modaliteti i vetëdijes	Kufja e djathtë	Dy shtypje
ANC joaktive	Kufja e djathtë	Dy shtypje
Vetëdijja e shpejtë	Kufja e djathtë	Vazhdoni të prekni pas sinjalit

Ndezja/fikja

Detyra	MFT	Punimi
Ndizini kufjet		Nxirrini kufjet nga kutia e karikimit për t'i ndezur
Fikini kufjet		Vendosini përsëri kufjet në kutinë e karikimit për t'i fikur

Kontrollimi i telefonatave dhe muzikës

Kontrolli i muzikës

Detyra	MFT	Punimi
Luani ose ndaloni muzikën	Kufja e djathtë	Mbajeni shtypur për 1 sekondë
Kënga tjetër	Kufja e djathtë	Tri shtypje
Kënga e mëparshme	Kufja e majtë	Tri shtypje
Rregullimi i volumit +/-		Nëpërmjet kontrollit të celularit

Kontrolli i telefonatave

Detyra	MFT	Punimi
Përgjigju një telefonate/ Ndrysho telefonuesin gjatë një telefonate	Kufja e djathtë	Dy shtypje
Mbyll telefonatën/ Refuzo telefonatën	Kufja e djathtë	Mbajeni shtypur për 1 sekondë

Asistenti me zë

Detyra	Butoni	Punimi
Aktivizo asistentin me zë (Siri/Google)	Kufja e majtë	Mbajeni shtypur për 2 sekonda
Ndalo asistentin me zë	Kufja e majtë	Një shtypje

Statusi tregues LED i kufjeve

Statusi i kufjeve	Treguesi
Kufjet janë të lidhura me një pajisje me Bluetooth	Drita treguese LED e ndezur për 2 sekonda
Kufjet janë gati për çiftim	Drita LED pulson ngjyrë blu dhe të bardhë me radhë
Kufjet janë të ndezura por nuk janë të lidhura me një pajisje me Bluetooth	Drita LED e bardhë pulson çdo sekondë (fiket automatikisht pas 3 minutash)
Nivel i ulët i baterisë (kufjet)	Drita LED blu pulson dy herë çdo 5 sekonda
Bateria është e karikuar plotësisht (kutia e karikimit)	Shikoni dritën LED të kasës

Drita treguese LED e kutisë së karikimit

Gjatë karikimit	Treguesi
Bateria e ulët	Drita LED portokalli ndizet
Bateria në gjendje relative	Drita LED e bardhë ndizet
Në përdorim dhe kapaku është i hapur	Treguesi
Bateria e ulët	Pulson portokalli për 4 cikle
Bateria në gjendje relative	Fikur

5 Rivendosja e kufjeve

Nëse hasni ndonjë problem me çiftimin ose lidhjen, mund të ndiqni procedurën e mëposhtme për t'i rivendosur kufjet në parametrat standarde të fabrikës.

- 1 Në pajisjen tuaj me Bluetooth, shkoni në menunë e Bluetooth dhe fshini **Philips TAT4507** nga lista e pajisjeve.
- 2 Çaktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth.
- 3 Kthejini kufjet në kutinë e karikimit, mbylleni kapakun dhe hapeni përsëri kapakun.
- 4 Shtypni butonin në kuti dy herë.
- 5 Ndiqni hapat në "Përdorimi i kufjeve - lidhja e kufjet me pajisjen tuaj me Bluetooth."
- 6 Çiftojini kufjet me pajisjen me Bluetooth, zgjidhni **Philips TAT4507**.

Nëse nuk ka asnjë reagim nga kufjet, mund të ndiqni hapin e mëposhtëm për të rivendosur harduerin e kufjeve.

- Shtypni dhe mbani shtypur butonin multifunksional për 10 sekonda.

6 Të dhëna teknike

- Koha e luajtjes së muzikës (ANC aktive): 5+16 orë
Koha e luajtjes së muzikës (ANC joaktive): 6+20 orë
- Koha e karikimit: 2 orë
- Bateri Lithium-ion 40 mAh në secilën kufje, bateri Lithium-ion 450 mAh në kutinë e karikimit
- Versioni i Bluetooth: 5.2
- Profilet e pajtueshme Bluetooth:
 - HFP (Hands-Free Profile)
 - A2DP (Advanced Audio Distribution Profile)
 - AVRCP (Audio Video Remote Control Profile)
- Audio-codecs që mbështeten: SBC, AAC
- Rrezja e frekuencave: 2.402-2.480 GHz
- Fuqia e transmetuesit: < 10 dBm
- Distanca e punimit: Deri në 10 metra
- Portë USB-C për karikim
- Paralajmërim për bateri të ulët: e disponueshme



Shënim

- Të dhënat mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara.

7 Njoftim

Deklarata e konformitetit

MMD Hong Kong Holding Limited deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të RED DIRECTIVE 2014/53/EU dhe UK Radio Equipment Regulations SI 2017 No 1206. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.philips.com/support.

Hedhja e produktit dhe baterisë së vjetër



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga European Directive 2012/19/EU.




Ky simbol do të thotë se produkti përmban një bateri të karikueshme të brendshme që mbulohet nga European Directive 2013/56/EU e cila nuk mund të hidhet së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Ju këshillojmë fort që ta çoni produktin te një pikë grumbullimi zyrtare ose në një qendër servisi të Philips në mënyrë që një profesionist ta heqë baterinë e karikueshme. Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive të karikueshme. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë e vjetra bashkë me mbetjet e zakonshme. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra dhe baterive të karikueshme ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.


Heqja e baterisë së brendshme

Nëse në vendin tuaj nuk ka sistem grumbullimi/riciklimi për produktet elektronike, mund ta mbroni mjedisin duke hequr dhe ricikluar baterinë para se t'i hidhni kufjet.

- Sigurohuni që kufjet të jenë shkëputur nga kutia e karikimit para se të hiqni baterinë.



- Sigurohuni që kutia e karikimit të jetë e shkëputur nga kabli USB i karikimit para se të hiqni baterinë.



Pajtueshmëria me EMF

Ky produkt i përmbahet të gjitha standardeve dhe rregullave lidhur me ekspozimin ndaj fushave elektromagnetike.

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin që të ndahet me lehtësi në tre materiale: karton (kutia), polistiroli (amortizuesi) dhe polietilieni (qeset, fletë mbrojtëse sfungjери).

Sistemi përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi ndiqni rregullat vendëse lidhur me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.

Njoftim për pajtueshmërinë

Pajisja është në përputhje me rregullat FCC, Pjesa 15. Përdorimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme:

1. Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme, dhe
2. Kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interferencë të marrë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë punim të padëshiruar.

Rregullat FCC

Kjo pajisje është testuar dhe është zbuluar se i përmbahet limiteve për një pajisje digjitale të Kategorisë B, sipas pjesës 15 të rregullave FCC. Këto llikto janë vendosur për të siguruar mbrojtje të arsyeshme ndaj interferencave të dëmshme në një ambient banimi. Pajisja gjeneron, përdor dhe mund të rrezatojë energji të frekuencave radio dhe, nëse nuk instalohet dhe nuk përdoret sipas manualit të udhëzimeve, mund të shkaktojë interferencë të dëmshme ndaj

komunikimeve radio.

Megjithatë, nuk ka garanci se nuk do të ketë interferencë në një ambient të caktuar. Nëse kjo pajisje shkakton interferencë të dëmshme ndaj sinjalit të radios ose televizionit, gjë që mund të përcaktohet duke e fikur dhe ndezur pajisjen, përdoruesi nxitet që të përpiqet ta korrigjojë interferencën duke ndjekur një ose më shumë nga masat e mëposhtme:

- Ndryshoni orientimin ose zhvendosni antenën
- Rritni hapësirën mes pajisjes dhe marrësit Lidhni pajisjen në një prizë që ndodhet
- në një qark të ndryshëm nga ai në të cilin është lidhur marrësi
- Konsultoni me shitësin ose me një teknik radio/TV me eksperiencë për ndihmë

Deklarata e ekspozimit të rrezatimit FCC:

Kjo pajisje përputhet me kufijtë FCC e ekspozimit ndaj rrezatimit të Kanadasë të përcaktuar për mjediset e pakontrolluara. Transmetuesi nuk duhet të ndodhet në të njëjtin vend me ndonjë antenë ose transmetues tjetër apo të punojë bashkë me to.

Kujdes: Përdoruesi paralajmërohet se ndryshimet ose modifikimet që nuk janë miratuar shprehimisht nga pala përgjegjëse për pajtueshmërinë mund ta bëjnë të pavlefshëm autoritetin e përdoruesit për të operuar pajisjen.

Kanada:

Kjo pajisje përmban transmetues/marrës të përjashtuar nga licencat të cilat i përmbahen RSS-ve të Inovacionit, Shkencës dhe Zhvillimit Ekonomik të Kanadasë të përjashtuar nga licencat. Përdorimi i nënshtrohet dy kushteve të mëposhtme: (1) Kjo pajisje nuk duhet të shkaktojë interferencë. (2) Kjo pajisje duhet të pranojë çfarëdo interferencë, duke përfshirë interferencat që mund të shkaktojnë punim të padëshiruar të pajisjes.

L'émetteur/récepteur exempt de licence contenu dans le présent appareil est conforme aux CNR d'Innovation, Sciences et Développement économique Canada applicables aux appareils radio exempts de licence.

L'exploitation est autorisée aux deux conditions suivantes : (1) L'appareil ne doit pas produire de brouillage; (2) L'appareil doit accepter tout brouillage radioélectrique subi, même si le brouillage est susceptible d'en compromettre le fonctionnement.

CAN ICES-003(B)/NMB-003(B)

Deklarata e ekspozimit të rrezatimit IC:

Kjo pajisje është në përputhje me limitet e Kanadasë për ekspozimin ndaj rrezatimit që janë përcaktuar për mjediset e pakontrolluara.

Transmetuesi nuk duhet të ndodhet në të njëjtin vend me ndonjë antenë ose transmetues tjetër apo të punojë bashkë me to.

8 Markat tregtare

Bluetooth

Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga MMD Hong Kong Holding Limited bëhet me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë u përkasin pronarëve të tyre përkatës.

Siri

Siri është një markë tregtare e Apple Inc., e regjistruar në SHBA dhe në shtete të tjera.

Google

Google dhe Google Play janë marka tregtare të Google LLC.

9 Pyetje të bëra shpesh

Kufjet e mia me Bluetooth nuk ndizen.
Niveli i baterisë është i ulët. Karikoni kufjet.

Nuk i çiftoj dot kufjet e mia me Bluetooth me pajisjen time me Bluetooth.

Bluetooth është çaktivizuar. Aktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj me Bluetooth dhe ndizeni pajisjen me Bluetooth para se të ndizeni kufjet.

Çiftimi nuk punon.

- Vendosini të dyja kufjet në kutinë e karikimit.
- Sigurohuni që të keni çaktivizuar Bluetooth të çdo pajisjeje tjetër me Bluetooth me të cilën jeni lidhur më përpara.
- Në pajisjen tuaj me Bluetooth, fshini "Philips TAT4507" nga lista e Bluetooth.
- Çiftoni kufjet (shikoni "Çiftimi i kufjeve me pajisjen Bluetooth për herë të parë" në faqen 6).

Pajisja me Bluetooth nuk i gjen dot kufjet.

- Kufjet mund të jenë lidhur me një pajisje të çiftuar më parë. Fikeni pajisjen e lidhur ose largojeni jashtë rrezes.
- Çiftimi mund të jetë fshirë ose kufjet janë çiftuar më parë me një pajisje tjetër. Çiftojini përsëri kufjet me pajisjen me Bluetooth siç tregohet në manual. (shikoni 'Çiftimi i kufjeve me pajisjen me Bluetooth për herë të parë' në faqen 6).

Kufjet e mia me Bluetooth janë lidhur me një telefon celular me Bluetooth stereo, por muzika luhet vetëm në boksën e celularit tim.

Shikoni manualin e përdorimit të celularit tuaj. Zgjidhni të dëgjoni muzikë përmes kufjeve.

Cilësia e audios është e dobët dhe mund të dëgjohej zhurmë e çjerrë.

- Pajisja Bluetooth është jashtë rrezes. Afroni kufjet dhe pajisjen Bluetooth, ose largoni pengesat mes tyre.
- Karikoni kufjet.

Cilësia e audios është e dobët kur përcillni audio nga një celular, është shumë e ngadaltë ose streaming nuk funksionon fare.

Sigurohuni që telefoni celular mbështet jo vetëm (mono) HFP, por mbështet edhe A2DP dhe është i pajtueshëm me BT.4.0x (ose më i lartë) (shiko "Të dhëna teknike" në faqen 11).

Kufja e djathtë dhe ajo e majtë janë të shkëputura nga njëra-tjetra.

- Vendosini të dyja kufjet në kutinë e karikimit, mbajeni kapakun të hapur.
- Shtypni shkurtimisht 3 herë butonin e kasës.



2021 © MMD Hong Kong Holding Limited. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Të dhënat mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara. Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka të tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt. Të gjithë emrat e tjerë të kompanive dhe produkteve mund të jenë marka tregtare të kompanive përkatëse.

